



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE  
(Provim me zgjedhje)**

**I RISHIKUAR**

**LËNDA:**

**EKONOMI E BËRTHAMË**

**VITI SHKOLLOR 2019-2020**

**Koordinator: Astrit Dautaj**

**PRILL 2020**

## 1. Hyrje

Pandemia COVID-19 ka prekur çdo fushë të veprimtarisë njerëzore dhe të gjithëve na është dashur të përshatemi me një ndryshim të papritur në mënyrën se si jetojmë. Ky ndryshim natyrisht ka përfshirë edhe arsimin.

Shumica e vendeve në Europë dhe më gjerë i kanë mbyllur institucionet arsimore për të kufizuar kontaktin mes njerëzve dhe për të parandaluar përhapjen e virusit. Edhe në vendin tonë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) i ka mbyllur institucionet arsimore që nga data 9 mars 2020.

Gjatë kësaj periudhe, MASR po mbështet mësuesit në përpjekjet e tyre për të realizuar procesin mësimor në kushtet e shtëpisë. Dy format kryesore mësimore që po zbatohen janë mësimet të xhiruara dhe të transmetuara në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) dhe puna mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale ose përmes platformave të ndryshme që mundësojnë krijimin e klasave virtuale (Google classroom, Google hangout, Edmodo, Zoom etj.). Këto janë format me të cilat kanë punuar të gjithë nxënësit, përfshirë edhe maturantët.

Për t'u ardhur në ndihmë maturantëve, ASCAP ka hartuar urdhrin nr.43, datë 22.04.2020, "Për rishikimin e programeve orientuese për provimet e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2019-2020, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19". Bazuar në urdhrin e mësipërm **nuk janë pjesë e këtij programi orientues** tematikat që janë zhvilluar gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë dhe që përkojnë me periudhën mars-qershor 2020.

Tematikat që nuk do të jenë pjesë e këtij programi, pra edhe e provimit të Maturës Shtetërore 2020, përveç se janë hequr nga Rubrika "REZULTATET E PRITSHME TË PROGRAMIT SIPAS TEMATIKAVE PËRKATËSE", por renditen edhe në rubrikën e fundit të këtij programi.

Procesi i rishikimit të programit orientues është realizuar nga specialistët e kurrikulës në ASCAP në bashkëpunim me mësues të lëndës.

# 1. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues i Maturës Shtetërore për lëndën “Ekonomi-Bërthamë”, përfshin konceptet më të rëndësishme të ekonomisë, njohuritë dhe aftësitë themelore që i duhen nxënësit në këtë lëndë. Programi orientues i Maturës Shtetërore për provimin me zgjedhje të lëndës së ekonomisë-bërthamë, për vitin shkollor 2018-2019, përbën një dokument të vlefshëm për mësuesit e gjimnazit, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e hartimit dhe vlerësimit të testit të maturës shtetërore.

- Programi përmban dhe siguron informacionin e nevojshëm për mësuesit e ekonomisë së gjimnazit që do të përgatisin maturantët për provimin e ekonomisë-bërthamë si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi orienton nxënësit për njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e ekonomisë-bërthamë si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të ekonomisë-bërthamë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesit. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të ekonomisë-bërthamë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore, duhet të mbajnë në vëmendje që nuk duhet të përfshijnë për vlerësim objektiva mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit duhet të përmbajnë vetëm ato koncepte, njohuri dhe aftësi të parashikuara në këtë program.

**Mësuesit** që do të përgatitin nxënësit për provimin e lëndës “Ekonomi-Bërthamë” t’i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet e përcaktuara në këtë program, por të trajtojnë me ta edhe çështje që nuk trajtohen në tekstin e përzgjedhur, por që përmbajnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e lëndës “Ekonomi-Bërthamë” të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, të koncepteve kyçe dhe të aftësive intelektuale të përcaktuara në program.

## **Kujdes!**

Në rastet kur njëri prej teksteve alternative nuk trajton një objektivi të caktuar të programit, atëherë **mësuesi i lëndës, që ka përzgjedhur këtë tekst, ka detyrën të plotësojë informacionin e domosdoshëm për realizimin e objektivit të përcaktuar.**

**Nuk është detyrë e nxënësit të sigurojë tekste të tjera për të realizuar objektivat e munguar!**

## 1.1 UDHËZIMI VEÇANTË

Testi në provimin me zgjedhje të maturës shtetërore në lëndën “Ekonomi-Bërthamë”, do të ndërtohet në bazë të kërkesave dhe objektivave të programit të lëndës “Ekonomi-Bërthamë”.

Testi **synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën e ekonomisë bërthamë**, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet.

Kjo do të thotë se:

- a. Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës. Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t’u testuar në këtë provim.
- b. Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë në lëndën e ekonomisë në shkollë, të tilla si:
  1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët i aftësive intelektuale).
  2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar i aftësive intelektuale).
  3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë i aftësive intelektuale).

### 1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (p. sh., toka, vegla pune etj.) ose jo të prekshme (p.sh., kërkesa, oferta.). Të identifikosh diçka, do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj. Për shembull, nxënësi të identifikojë faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim
- **Të përshkruash** do të thotë të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj. Për shembull, nxënësi të përshkruajë rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre

### 2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- **Të shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, p.sh.: shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara. Për shembull, nxënësi të shpjegojë konceptet pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur...
- **Të analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, p.sh., për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose

ekonomike. Pë shembull, nxënësi të analizojë ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër

### 3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara

- **Të vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, p.sh., për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj. Për shembull, nxënësi të vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar.
- **Të marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri. Për shembull, nxënësi të mbajë qëndrimin e tij për shkallën e ndërhyrjes së shtetit në ekonominë e tregut.
- **Të mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim, ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd. Për shembull, nxënësi të mbrojë me argumente qëndrimin e tij për politikën e rritjes ose të uljes së taksave, duke mbajtur parasysh të gjitha argumentet e kundërta me të tija.

### Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli i ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

#### Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni, që mund të maten/vlerësohen:

1. me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, të cilët nxënësi, pasi i lexon ose i analizon në një material të caktuar informativ, i plotëson me një ose me më shumë detyra;
2. me anë të testeve me përgjigje të kufizuara;
3. me anë të testeve me përgjigje të zgjeruara.

#### 1. Rezultate të mësuarit, që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, janë aftësitë:

- për të dalluar lidhjet shkak-pasojë;
- për të dalluar zbatimin e parimeve;
- për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen;
- për të dalluar hipoteza të arsyeshme;
- për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

**2. Rezultate të mësuar, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të kufizuara, janë aftësitë:**

- për të shpjeguar lidhjet shkak-pasojë;
- për të përshkruar zbatimin e parimeve;
- për të paraqitur argumente të vlefshme;
- për të formuluar hipoteza të arsyeshme;
- për të formuluar përfundime të vlefshme.

**3. Rezultate të mësuar, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të zgjeruara, janë aftësitë:**

- për të prodhuar, për të organizuar dhe për të shprehur ide;
- për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes;
- për të krijuar modele origjinale;
- për të vlerësuar ide të vlefshme.

## 2. TEMATIKAT

### TEMATIKA 1: EKONOMIA E TREGUT

Nëntemat	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
<b>1.1 Çfarë studion ekonomia?</b>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• shpjegon konceptet pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune.</li><li>• jep shembuj personal lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj;</li><li>• identifikon faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim;</li><li>• interpreton një lakore të mundësive të prodhimit si dhe nëpërmjet saj ilustron koston oportune”;</li><li>• vlerëson mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor;</li><li>• përshkruan veçoritë e shtyllave të sistemit ekonomik të iniciativës së lirë;</li><li>• përshkruan rolin e fitimit në sistemin e sipërmarrjes së lirë;</li><li>• analizon se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor;</li><li>• përshkruan fluksin e qarkullimit të aktivitetit ekonomik që lidh familjet, firmat e biznesit dhe qeveritë në ekonominë e tregut.</li></ul>
<b>1.2. Kërkesa, oferta, dhe çmimi i tregut</b>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• interpreton konceptet: treg, çmim, kërkesë, ofertë;</li><li>• formulon ligjin e kërkesës dhe ofertës;</li><li>• interpreton lakoren e kërkesës dhe ofertës;</li><li>• shpjegon faktorët që shkaktojnë zhvendosjen e kërkesës dhe ofertës;</li><li>• përcakton çmimin ekuilibër të një produkti të dhënë kur janë dhënë kërkesa dhe oferta për këtë produkt nëpërmjet grafikut;</li><li>• bën dallimin midis një ndryshimi në sasinë e kërkuar ose të ofruar dhe një ndryshimi në kërkesë ose në ofertë;</li><li>• vlerëson ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar dhe të ndryshimeve të elasticitetit të ofertës në sasinë e ofruar.</li><li>• shpjegon se si ndikojnë në çmimin e tregut ndryshimet në kërkesë dhe ofertë;</li><li>• analizon ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër;</li><li>• shpjegon se si çmimet e tregut bëjnë racionimin e mallrave dhe shërbimeve dhe motivojnë njerëzit për prodhimin e tyre;</li></ul>
<b>1.3. Konsumatori në ekonominë e tregut</b>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• përshkruan rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e</li></ul>

	<p>tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon avantazhet dhe disavantazhet e blerjes me kredi;</li> <li>• shpjegon arsyet pse njerëzit kursejnë;</li> <li>• krahason metodat e ndryshme të kursimit;</li> <li>• analizon faktorët që ndikojnë në masën e kursimit;</li> <li>• përgatit një buxhet personal.</li> </ul>
<p><b>1.4. Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon se si tregu i lirë nxit sipërmarrjen;</li> <li>• rendit format kryesore të organizimit të biznesit;</li> <li>• gjykon për avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tri formave kryesore të biznesit;</li> <li>• shpjegon organizimin e korporatës</li> <li>• gjykon për disa nga përgjegjësitë, kërkesat dhe përfitimet që lidhen me sipërmarrjen;</li> <li>• dallon burimet e brendshme nga burimet e jashtme të financimit të biznesit;</li> <li>• shpjegon qëllimet dhe format e burimeve financiare të biznesit;</li> <li>• dallon ndryshimin ndërmjet aksionit dhe obligacionit;</li> <li>• analizon një bilanc dhe një pasqyrë të rezultateve financiare të firmës.</li> </ul>
<p><b>1.5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• bën dallimin midis kostove fikse dhe atyre variabël;</li> <li>• llogarit koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale;</li> <li>• interpreton grafikun e kostos fikse, variabël, të përgjithshme, mesatare, marxhinale;</li> <li>• llogarit të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat marxhinale dhe të ardhurat mesatare;</li> <li>• llogarit produktin e përgjithshëm fizik, marxhinal, mesatar;</li> <li>• zbulon veprimin e ligjit të të ardhurave zbritëse në gjendjen e biznesit.</li> <li>• shpjegon funksionin e prodhimit për periudhën afatshkurtër</li> <li>• tregon si llogaritet prodhueshmëria dhe si ndikon ajo në standardin e jetesës.</li> <li>• evidenton faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri</li> </ul>
<p><b>1.6. Struktura e tregut</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• interpreton konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut;</li> <li>• identifikon nivelin e konkurrencës së tregjeve në ekonomi;</li> <li>• shpjegon karakteristikat e secilës nga strukturat kryesore të tregjeve: konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol;</li> <li>• diskuton raportet dhe format e shkrirjes së bizneseve;</li> <li>• krahason strukturat e ndryshme të tregjeve;</li> <li>• analizon efektet ekonomike të strukturave të tregut mbi ekonominë dhe konsumatorin</li> <li>• argumenton se zhvillimi i konkurrencës së lirë është në favor të të gjitha subjekteve në ekonominë e tregut.</li> </ul>



<b>1.7 Tregjet e faktorëve të prodhimit</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• interpreton ofertën dhe kërkesën për faktorët e prodhimit;</li> <li>• interpreton ofertën për punë dhe kërkesën për punë;</li> <li>• shpjegon se si kërkesa dhe oferta për punë përcaktojnë çmimin e punës, çmimin e kapitalit, çmimin e tokës;</li> <li>• vlerëson shkallën në të cilën forcat e tregut dhe forcat jo të tregut ndikojnë në pagat.</li> </ul>
---	---

## TEMA 2: EKONOMIA KOMBËTARE

Nëntemat	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
<b>2.1. Qeveria dhe ekonomia</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon funksionin e qeverisë si arbitër dhe si subjekt në ekonominë e tregut;</li> <li>• shpjegon pse pjesëmarrja e qeverisë në ekonomi është rritur gjatë viteve;</li> <li>• përshkruan disa nga të ardhurat kryesore dhe shpenzimet në buxhetin për qeverinë shqiptare;</li> <li>• shpjegon arsyet që qeveria vendos taksa dhe pse taksimi nga qeveria është i nevojshëm;</li> <li>• vlerëson taksat, bazuar në parimet e vendosjes së tyre.</li> <li>• krahason tipat e ndryshëm të taksave, duke përfshirë taksat progresive, regresive dhe proporcionale;</li> <li>• interpreton konceptet e deficitit buxhetor, e borxhit publik dhe lidhjen midis tyre;</li> <li>• analizon përparësitë dhe mangësitë e deficitit buxhetor dhe borxhit publik;</li> <li>• përshkruan një ose disa propozime për të ulur deficitin buxhetor.</li> </ul>

## 3. PESHAT E TEMAVE

TEMA	PESHA NE %
<b>Tema 1</b>	
1.1 Çfarë studion ekonomia?	6%
1.2. Kërkesa oferta dhe çmimi i tregut	10%
1.3. Konsumatori në ekonominë e tregut	4 %
1.4. Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij	8%
1.5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës	5%
1.6. Struktura e tregut	3%

<b>Tema 2</b>	
2.1. Qeveria dhe ekonomia	

## TEMAT QË PËRJASHTOHEN NGA PROGRAMI I MATURËS SHETËRORE

<b>Progami</b>	<b>Temat që nuk janë pjesë e progamit të Maturës Shtetërore 2020</b>
Programi orientues i lëndës Ekonomi	<p><b>Lënda: Ekonomi</b></p> <p><b>Tema 2</b>  2.2. Paraja dhe institucionet financiare  2.3 Treguesit kryesorë makroekonomik  2.4. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike</p> <p><b>Tema 3</b>  3.1 Tregtia ndërkombëtare</p> <p><b>Tema 4</b>  4.1 Etika e biznesit  4.2 Aftësi për sukses  4.3. Financat personale  4.4 Bëhu sipërmarrës!</p>